

FTESË PËR OFERTË

Numri i prokurimit: T-026-09-2022

- I. Autoriteti kontraktues:** Banka për Biznes Sh. A.
- II. Lënda e kontratës:** Ofrimi i shërbimeve të telefonisë mobile
- III. Procedura e përdorur:** E hapur
- IV. Kushtet e ofertimit:**

a) Afati kohor dhe vendi i dërgimit të ofertave:

- Afati i fundit për dërgimin e ofertës në bankë është data **3 tetor 2022** deri në ora **14:00**
- Oferta duhet të dërgohet në formë elektronike në email adresën prokurimi@bpbbank.com.

Vërejtje:

- Kompania ofertuese duhet të dërgoj dokumentacionin e nevojshëm ligjor – Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit, Çertifikatën e TVSH-së dhe Çertifikatën e Numrit Fiskal.
- Banka për Biznes është deklarues i TVSH-së. Të gjitha çmimet e deklaruara nga ofertuesit të cilët janë deklarues të TVSH-së duhet që ta listojnë ndarësi vlerën e TVSH-së. Çmimet të cilat nuk e kanë të ndarë vlerën e TVSH-së do të nënkuptohet se ajo është e përfshirë në çmim.
- Çmimet duhet të kuotohen në Euro.
- Kompania ofertuese duhet të paraqesë referencat e saja për shërbime të ngjashme.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë tre muaj (90 ditë) nga dita e dërgimit.
- Oferta duhet të dërgohet në gjuhën shqipe.
- Banka për Biznes ka të drejtë që të anuloj tenderin dhe/ose të ndryshoj karakteristikat e tenderit dhe t'i ftoj sërish kompanitë që të i sjellin prapë ofertat tyre.
- Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

Dokumentet për aplikim mund të kërkohen nga data **19 shtator 2022** në email adresën prokurimi@bpbbank.com dhe atë çdo ditë pune gjatë orës 10:00-15:00.